



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORE

Nr. 803 Prot ( A.R. )

Vlore 14.11.2016

Lenda: Dergohet urdher ekzekutimi.

Drejtuar: ZYRES VENDORE TE SHERBIMIT TE PROVES  
 V L O R E

ZYRES RAJONALE TE KTHIMIT DHE KOMPESIMIT TE PRONAVE  
 V L O R E

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
 KANCELARISE  
 V L O R E

ZYRES PERMBARIMORE  
 V L O R E

Per dijeni: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
 V L O R E

Shtetasit: Timotheo Dhimolea  
 Banues ne lagjen: "Isa Boletini", P.1283  
 V L O R E

Bashkelidhur ju dergojme urdherin nr. 1233, date 14.11.2016 " Per ekzekutimin e vendimit penal te formes se prere nr. 659, date 03.12.2015 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore".

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

<sup>u</sup> DREJTUESI I PROKURORISE

Ramadan TROCI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORE

URDHER

Nr. 1233, Date 14.11.2016

PER EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR. 659, DATE 03.12.2015  
TE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE VLORE

Ne Vlore sot me date 14.11.2016, Une, Skender Dautaj, Prokuror ne Prokurorine Prane Gjykeses se Shkalles se Pare Vlore, pasi u njoha me vendimin nr. 659, date 03.12.2015 te Gjykeses se Shkalles se Pare Vlore me te denuarin Timotheo Dhimolea, atesia Petro, amesia Fotina, i datelindjes 24.08.1953, lindur dhe banues ne lagjen " Isa Boletini " , pallati nr. 1283 te bashkise Vlore, hetuar dhe gjykuar pa mase sigurimi, mbrojtur nga av. S. Zeneli, derguar me shkresen nr. 1320 prot. dt. 10.11.2016,

Konstatova

1. Me vendimin nr. 659, date 03.12.2015 Gjykata e Shkalles se Pare Vlore ka vendosur deklarimin fajtor te te pandehurit Timotheo Dhimolea, per kryetjen e vepres penale te parashikuar nga neni 186/2 te Kodit Penal dhe denimin e tij me 2 vjet burgim .

2. Gjykata ne aplikim te nenit 406 te Kodit Pr.Penale ka urdheruar zbritjen e 1/3 se mases se denimit me burgim.

3. Gjykata ka urdheruar qe vuajtja e denimit te filloj nga data e ekzekutimit te vendimit penal te formes se prere dhe te kryhet ne burgun e sigurise se zakonshem.

4.Gjykata ne zbatim te nenit 391/1 te Kodit Pr.Penale, ka urdheruar qe dokumentat e sekuestruar te poshteshenuara :

- Vendimi nr. 425, date 30.12.2008 te Z.R.K.K.P Vlore si dhe planvendosja e prones bashkelidhur ketij vendimi, vertetimi nr. 2377, date 30.12.2008 te Z.R.K.K.P Vlore dhe shkresa nr. 5111/1 prot., date 15.03.2012 e Z.R.K.K.P Vlore, **te deklarohen te falsifikuara dhe te asgjesohen.**

5. Gjykata ne zbatim te nenit 36/b te Kodit Penale, ka urdheruar qe produkti i vepres penale te " Falsifikimit te dokumenteve" *me me shume se nje here* te parashikuar nga neni 186/2 te Kodit Penal e ndodhur nen efektin e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive, pasuria e palujtshme me siperfaqe totale 128.000 ( njeqinde njezete e tete ) mije m2 e ndare ne pasurite e meposhteme, :

5/1. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 230, date 20.06.2012,ZK 2863 me siperfaqe 70.000 m2 me nr.1. ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase. bashkia Himare e regjistruar ne emer te bashkepronareve " Dhimolea ", **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/2. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 230, date 20.06.2012, ZK 2863 me siperfaqe 1.000 m2 me nr.3. ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase. bashkia Himare e regjistruar ne emer te bashkepronareve " Dhimolea ", **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/3. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 230, date 20.06.2012, ZK 2863 me siperfaqe 3.000 m2 me nr.5. ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ". fshati Palase, bashkia Himare e regjistruar ne emer te bashkepronareve " Dhimolea ", **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/4. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 230, date 20.06.2012, ZK 2863 me siperfaqe 22.000 m2 me nr.6. ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase, bashkia Himareeregjistruar ne emer te bashkepronareve " Dhimolea ", **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/5. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 24, date 29.01.2013, ZK 2863 me siperfaqe 27.000 m2 me ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase, bashkia Himare e regjistruar ne emer te bashkepronareve " Dhimolea ", **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/6. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 73, date 13.03.2013, ZK 2863 me siperfaqe 3.000 m2 me ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase, bashkia Himare e regjistruar ne emer te shtetasit Rustem Dishaj, **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

5/7. Pasuria e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. 73, date 13.03.2013, ZK 2863 me siperfaqe 2.000 m2 me ndodhur ne vendin e quajtur " Maitka ", fshati Palase, bashkia Himare e regjistruar ne emer te shtetasit Kledjon Ramaj, **te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.**

6. Gjykata ka urdheruar shpenzimet gjyqesore ne shumen 5.000 leke te paguhen nga i pandehuri.

**Vendimi nr. 659, date 03.12.2015 i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore eshte bere i formes se prere me vendimin nr. 560, date 12.10.2016 te Gjykates se Apelit Vlore e cila ka vendosur:**

Lenien ne fuqi te vendimit penal nr. 659, date 03.12.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore me ndryshimin :

- Gjykata ne zbatim te nenit 59 te Kodit Penale ka urdheruar pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe venien e te pandehurit Timotheo Dhimolea ne prove per nje periudhe kohore prej 3 vitesh me kushte qe te mos kryej veper tjeter penale.

- Gjykata ka urdheruar qe i denuari Timotheo Dhimolea te paraqitet para Zyres Vendore te Sherbimit te Proves Vlore dhe te plotesoj gjithë detyrimet e percaktuara ne kete vendim penal.

*Sa me siper, dhe bazuar ne nenet 462,464, 465, 486/1 te Kodit te Pr.Penale, nenet 12, 17, 22 e 23 te ligjit nr 8331, date 21.04.1998 "Per ekzekutimin e vendimeve penale"*

### URDHEROJ

1. Ekzekutimin e vendimit nr. 659, date 03.12.2015 i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore bere i formes se prere me vendimin nr. 560, date 12.10.2016 te Gjykates se Apelit Vlore me te denuarin Timotheo Dhimolea per mbajtjen e kontaktit me sherbimin e proves, per asgjesimin e dokumentave, per sekuestrimin e pasurise dhe pagimin e shpenzimeve gjyqesore.

2. Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra Vendore e Sherbimit te Proves Vlore.

3. Per ekzekutimin e ketij vendimi lidhur me asgjesimin e dokumentave te sekuestruara ngarkohet Zyra e Kancelarise se Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe Z.R.K.K.P Vlore.

4. Per ekzekutimin e ketij vendimi lidhur me sekuestrimin dhe regjistrimin e prones ne favor te shtetit Z.R.K.K.P Vlore.

5. Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra Permbaremore Vlore.

6. Me kete urdher te vihet ne dijeni i denuari si dhe Gjykata e Shkalles se Pare Vlore.

7. Per zbatimin e ketij urdherimi te njoftohet me shkrim Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore.

**PROKUROR  
SKENDER DAUTAJ**

